



In medias res

Çfarë duhet të ndryshojë në arsimin e Kosovës (2)?

Nga viti 1999, e më pas, falë angazhimit të Bashkësisë Ndërkombëtare, janë ndërmarrë nisma të shumta reformuese. Shuma të mëdha të parash janë derdhur për ringjalljen e sistemit të arsimit i cili me dekada për arsyt e njohura ideologjike shtetmëdha ka qenë i instrumentalizuar nga politikat e bazuara në identitete etnike që më në fund prodhoi edhe konfliktin e armatosur në fund të dekadës së shekullit XX. Pjesa më e madhe e këtyre nisma reformuese nuk arriti dhe nuk bëri që sistemi i arsimit të dalë nga kriza, andaj për të dalë nga kjo gjendje nevojitet ndryshim në **qasje**. Pra, ndryshimi i parë që duhet të bëhet është ndryshimi i qasjes. Deri më tani arsimi është trajtuar në mënyrë fragmentare, parciale dhe segmentare. Kjo qasje parciale dhe segmentare ka bërë që nga problemet e shumta (thënë në mënyrë metaforike: nga drunjtë nuk e kemi parë mali) të mbeten shumë gjera, segmente, fragmente ose tërësisht të pa përfshira në ndryshim, ose të përfshihen në mënyrë rutimore dhe pa përkujdesje të duhur. Kështu p.sh. Arsimi Para-universitar është trajtuar ndaras nga Arsimi Universitar. Kjo qasje ka bërë që në Kosovë të kemi tani katër strategji zhvillimore, tërësisht inkompatibile dhe që në start të pa aplikueshme dhe të padobishme sepse siç është e njohur arsimi parauniversitar ka ndikim të fuqishëm në arsimin universitar dhe ai universitar në atë para-universitarë. Trajtimi separat i këtyre dy nivele ke bërë që strategjitë të mos kenë koherencë, shumë çështje relevante në të gjitha nivelet të mos trajtohen fare apo të mos trajtohen në mënyrë të duhur dhe koherente.

Produkti i parë i një qasje të këtillë është mungesa e një vizioni zhvillimor për sistemin e arsimit të Kosovës. Në mungesë të këtij vizioni zhvillimor, sot askush në Kosovë nuk e ka të qartë në të cilin drejtim duhet shkojë sistemi i arsimit, apo cila është ajo pikë referente në fund të tunelit drejt të cilës duhet të shkojë zhvillimi i arsimit i këtij vendi. Pa një vizion të qartë zhvillimor të sistemit të arsimit i cili vizion do të përmbledhë interesat, dëshirat dhe shpresat e të gjithë qytetarëve të Kosovës pavarësisht prej përkatësisë së tyre etnike, racore, gjuhësore, gjinore, fetare, ekonomike dhe sociale, arsimi i Kosovës do ketë tundje dhe kriza.

Vetëm atëherë kur ky vizion bëhet zë, vullnet dhe dëshirë e të gjithë qytetarëve të Kosovës do të sigurohet mobiliteti qytetar, do të arrihet konsensusi pa të cilin ndryshimet asnjëherë nuk do të mund të realizohen interesat e të gjithë qytetarëve.

Sistemi i arsimit në gjuhën serbe, i cili sot është në kundërshtim më të gjitha aktet ndërkombëtare dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës qeveriset dhe udhëhiqet nga një vend dhe një shtet tjetër, duhet të integrohet në sistemin e arsimit të Kosovës. Ky vizion nuk mund të krijohet sipas masës së shumicës, por sipas masës dhe të interesit qytetar, përkatësisht sipas masës së njeriut. Formulimi i një vizioni të këtillë zhvillimor është i mundur dhe ky mund të behet, por kërkon kohe, debate dhe diskutime, marrëveshje etj.

Në atë moment, që ky vizion bëhet edhe vizion i qytetarit të Kosovës që realizon ëndrrën e tij, arsimi bëhet pronë e tij. Në këto aspekte mediet e shkruara dhe pamore e kanë rolin shumë të madh dhe të pazëvendësueshëm. Ndryshimi i parë, pra, ka të bëjë me atë se sistemi i arsimit duhet të trajtohet si një sistem i tërësishtëm ultrastabil dhe koherent. Në vend të qasjes provizore dhe hamendësore duhet të nisemi nga qasja e Teorisë së Përgjithshme të Sistemeve.

Çështja e dytë që duhet të ndryshoj është **mendësia**. Për këtë do të shkruajmë në vazhdim

Shkroi: Halim Hyseni

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSh

■ Gjatë muajit tetor është bërë monitorimi i mësimdhënësve të komunës së Obiliqit, të cilët janë duke vijuar programin “Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit- MKLSh”. Trajnerët kanë raportuar se mësimdhënësit ishin përgatitur vërtetë mirë në zbatimin me sukses të teknikave dhe strategjive të mësuara në klasat e tyre. Ata raportojnë se në mesin e mësimdhënësve vërehej një mobilizim i shtuar për të arritur objektivat e njesisë mësimore në klasat e tyre. Edhe pse pjesa më e madhe e mësimdhënësve me sukses organizuan orën në bazë të metodologjisë së MKLSh-së, pati dhe nga ata të cilët kanë nevojë për këshilla. Diskutimi i anëve pozitive të orëve të monitoruara dhe këshillat për përmirësim u bë më 18 tetor 2009. Seminari i pestë për këtë grup të mësimdhënësve u mbajt më 17-18 tetor. Gjatë seminarit vërehej një interesim i shtuar i mësimdhënësve për të kuptuar më mirë teknikat si nevojë për zbatimin e tyre në klasë. Mësimdhënësit u njoftuan se seminari i gjashtë do të mbahet më 7-8 nëntor.

■ Më 20-22 tetor 2009 ka filluar trajnimi i 25 drejtorëve të shkollave të komunës së Prishtinës dhe Obiliqit. Gjatë këtyre 3 ditëve trajnerët kanë paraqitur para drejtorëve përmbajtjet e udhëzuesve 1 dhe 2 të programit të MKLSh-së. Trajnimi i drejtorëve ka për qëllim aftësimin e drejtorëve për të realizuar me sukses monitorimin e mësimdhënësve të tyre në klasa. Seminari tjetër është paraparë të mbahet më 17-19 nëntor 2009.

Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës

■ Gjatë muajit tetor, KEC ka vazhduar zbatimin e projektit “Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës”. Në fillim të muajit janë identifikuar nga 3 monitorë në 5 komunat e Kosovës: nga Prishtina, Gjilani, Gjakova, Vushtrria dhe Istogu. Për monitorët janë mbajtur tri seminare:

- Korrupsioni – kuptimi, format e manifestimit dhe strategjitë për luftimin e tij.
- Financat qendrore dhe lokale – grumbullimi dhe shpenzimi me theks të veçantë në financat në arsim.
- Korniza e monitorimit – aspekte praktike të monitorimit.

Seminari i parë është mbajtur më 10-11 tetor, i dyti më 17-18 tetor, ndërsa seminari i tretë më 25 tetor. Gjatë seminarit të tretë, monitoruesve iu shpërnda korniza e monitorimit, si një udhërrëfyes për të realizuar procesin e monitorimit. Po ashtu, monitoruesve iu shpërndanë dhe instrumentet për monitorim.

Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

■ Gjatë muajit tetor 2009, është bërë monitorimi inicial në 97 shkolla pilot në Prizren, Gjilan dhe Gjakovë. Në monitorim kanë marrë pjesë: Drejtori i Drejtorisë Komunale në Prizren, Nexhat Çoçaj dhe Reshit Kushaj, zyrtarë në Drejtorinë Komunale në Prizren; Halim Vranovci dhe Shqipe Kastrati, zyrtarë në Drejtorinë komunale në Gjilan dhe; Myftar Shala, zyrtar në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Gjakovë. Qëllimi i monitorimit inicial ka qenë të konstatohet shkalla e zbatimit të projektit. Me këtë rast

është bërë incizimi i gjendjes së sigurisë në objektet shkollore, janë siguruar informacione relevante për atmosferën dhe klimën, si dhe për shkallën e mobilitetit të shkollave në zbatimin projektimit.



Në monitorim janë siguruar mbi 2000 fotografi, janë bërë 97 intervista me drejtorë, me nxënës, dhe mësimdhënës. Gjatë kësaj kohe janë formuar 97 Këshilla koordinuese për zbatimin projektit me 487 anëtarë, është bërë rrethimi i 9 oborreve, janë vendosur 97 Kutia për të Drejta e Fëmijës, janë formuar 18 kënde shkollore për të drejtat e fëmijës. Janë mbjellë mbi 120 fidanë të pemëve të ndryshme. Në 97 shkolla janë caktuar nxënësit ndihmës për të ndihmuar sigurinë, si dhe për të ndihmuar në parandalimin e të gjitha llojeve të dhunës. Të gjitha shkollat janë duke vlerësuar gjendjen e sigurisë me paketën treguesve sasior dhe cilësor e hartuar nga KEC.

Ngritja e cilësisë në edukimin e fëmijërisë së hershme

■ Trajnimi për monitorimin e mësimdhënësve dedikuar drejtorëve, zëvendësrejtoreve, pedagogëve të shkollave fillore dhe institucioneve parashkollore, si dhe zyrtarëve të arsimit.

Me kërkesën e Drejtorive Komunale të Arsimit dhe Zyrave të Inspektimit në ato komuna ku ka filluar të organizohen trajnimet për drejtorët e shkollave fillore dhe Institucioneve parashkollore u organizua trajnimi për zyrtar të arsimit. Trajnimi u mbajt në Prishtinë me 5-7 tetor dhe morën pjesë 25 zyrtar të DKA dhe Zyrave të Inspektimit. Pas trajnimit me datën 20 tetor u organizua edhe pjesa praktike për zyrtarët e arsimit. Të gjithë pjesëmarrësit patën rast të ushtrjnë monitorimin sipas instrumentit të prezantuar në trajnim. Monitorimi u organizua në shkollën fillore "Faik Konica" në Prishtinë me ç' rast u organizua edhe një punëtori me qëllim të shkëmbit të përvojave nga monitorimi.

■ Po ashtu ky trajnim u organizua edhe për të gjithë drejtorët e Institucioneve parashkollore me datat 12,13,14 tetor në Prishtinë. Pjesa praktike e monitorimit për këtë grup pritet të mbahet gjatë nëntorit.

■ Gjatë muajit tetor janë organizuar edhe nga dy monitorime në praktikë për drejtorët shkollave fillore të komunave të Skenderajt, Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës grupi II. Të gjithë pjesëmarrësit të cilët i kanë plotësuar kushtet pas monitorimit janë certifikuar.

KOSOVISION Contest

■ Aktivitetet e këtij projekti nuk kanë të ndalur. Muaji tetor ishte muaji kur të gjitha klasat e pesta të mbarë Kosovës janë në vllugun më të madh të punëve në projekt. Janë bërë vazhdimisht monitorimet nëpër shkolla dhe deri tani kemi pjesëmarrje shumë të madhe të klasave të pesta në projekt. Këtë muaj, pra më 13 tetor është mbajtur edhe një Konferencë për media në Ministrinë e Arsimit, ku të gjithë bashkëpunëtorët e projektit treguan për rëndësinë që ka ky projekt dhe që Ministria e Arsimit është

shumë e interesuar që nxënësit të jenë pjesëmarrës të projektit.



Po ashtu edhe Kompania "Rrota" e cila bën përcjelljen mediale dhe xhirimin e klasave të cilat janë pjesëmarrëse në projekt, këtë muaj ka filluar me xhirime të cilat pastaj i dërgon në RTK për transmetim.



Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të këtij projekti "Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit", financuar nga Komisioni Evropian, janë organizuar disa aktivitete. Këtë muaj është organizuar trajnimi i grupit të Prishtinës dhe Fushë Kosovës për monitoruesit e brendshëm

dhe ata të jashtëm të shkollave të cilat janë pjesëmarrëse në projekt.

Monitoruesit, në këtë trajnim janë pajisur me materialet e nevojshme të punës, si dhe kanë bërë ndarjen e detyrave, respektivisht ndarjen e shkollave të cilët ata do ta monitorojnë. Të gjithë monitoruesit e brendshëm dhe ata të jashtëm kanë filluar me mbledhjen e të dhënave për shkollat dhe që nga fundi i këtij muaji kanë filluar edhe të bëjnë shpërndarjen e pyetësorëve nëpër shkolla dhe përzgjedhjen e atyre të cilët do të jenë pjesë e këtij hulumtimi.



Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

■ Në kuadër të komponentës 2 të Projektit "Hulumtimet Kombëtare" grupi i ekspertëve nga Rumania dhe Anglia i kanë hartuar kornizën për hulumtim. Kjo kornizë u është dërguar të gjithë hulumtuesve përgjegjës në shtetet pjesëmarrëse në projekt, të cilët kanë pas kohë për ta shikuar dhe komentuar. Pasi që nuk ka pas vërejtje kjo është konsideruar si versioni përfundimtar i kornizës dhe është duke u përdorur për hulumtim në të gjitha shtetet.

■ Sa i përket komponentës 3 të projektit "Praktikat më të mira" shtetet pjesëmarrëse në projekt i kanë emëruar ekipet kombëtare të cilat do të punojnë për

mbledhjen e praktikave më të mira sa i përket përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së pakicave në arsim. Gjithashtu grupi i ekspertëve ka filluar hartimin e kornizën për mbledhjen e praktikave më të mira e cila do të diskutohet në takimin virtual të grupit qendror punues.

Prevention on Peer Violence

■ Përgatitjet për trajnim të mësimdhënësve janë bërë. Të gjitha materialet e nevojshme për trajnim të mësimdhënësve i janë dërguar shkollave. Pjesa e dytë e trajnimit për mësimdhënës në kuadër të këtij projekti, është mbajtur më datën 24 tetor 2009 në shkollat "Hasan Prishtina", "Mitrush Kuteli", "Ganimete Tërbeshi", "Dardania" dhe "Zenel Hajdini" ndërsa më 31 tetor në shkollat "Asim Vokshi", "Iliria", "Gjergj Fishta", "Nazim Gafurri" dhe "Hilmi Rakovica". Në këto trajnime kanë qenë prezent edhe psikologët të cilët janë pjesë e këtij projekti.

■ Në këtë muaj po ashtu janë bërë edhe disa përgatitje për fillimin e punëtorive me nxënës të cilat duhet të fillojnë në muajin nëntor të vitit 2009.

Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës

■ Gjatë muajit tetor në kuadër të projektit "Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës" është mbajtur prezantimi para mësimdhënësve të shkollës "Hilmi Rakovica" për metodologjinë dhe procedurat e zhvilluara nga grupi punues për avancimin e komunikimit me prindër. Gjithashtu janë monitoruar të gjitha shkollat gjatë takimeve individuale me prindër.

Access Microscholarship Program

■ Orët e Access janë mbajtur rregullisht për të dy grupet e Prishtinës gjatë muajit tetor. Një nga orët e kursit të gjuhës angleze u mbajt në picerinë Proper Pizza ku fëmijët patën rastin të dalin pak nga ambienti i Këndit Amerikan dhe të shoqërohen mes vete.

Fatkeqësisht, grupi i Prizrenit nuk ka filluar ende ti mbajë orët për shkak të mungesës së profesorit të gjuhës angleze. Përgjegjësit në Ambasadën Amerikane janë duke u munduar ta sigurojnë një profesor dhe shpresojmë që së shpejti edhe atje do të fillojnë të mbahen orët.

Edukimi për Drejtësinë Shoqërore

■ Gjatë muajit tetor ka filluar implementimi i projekti Edukimi për Drejtësinë Shoqërore që përkrahet nga Ambasada Amerikane. Aktiviteti i parë i këtij projekti është mbajtja e Trajnimit për Trajner nga ekspertë amerikane të kësaj fushe. Pastaj, do të organizohen trajnime në 4 qendra të Kosovës. Në këto trajnime trajnerët vendor do të kenë mundësinë e transmetimit apo shpërndarjes së njohurive të reja që do ti marrin në ToT Projekti do të zgjatë 4 muaj.

Koncepti i qytetarisë te nxënësit e shkollës fillore në Kosovë

■ Me datën 19-21 tetor u mbajt një punëtori hyrëse për projektin "Koncepti i qytetarisë te nxënësit e shkollës fillore në Kosovë". Në të vërtetë, ky është një paraprojekt, sepse vet qëllimi i tij është

zhvillimi i një projekti kërkimor, për të cilin do të kërkohet financim nga burimet zvicerane. Pra, aktivitetet kryesore të këtij projekti lidhen me zhvillimin e konceptit të projektit kërkimor, i cili do të realizohet nëse për të sigurohet financimi. Partnerë janë: Universiteti i Edukimit në Zurich, KEC dhe Fakulteti i Edukimit.

Përgatiti: Petrit Tahiri